



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE MËRGATË

DATE/A:Nr.Prot	31.03.2026-Suharekë
PËR/TO:	Kryetari i Komunës Bali Muharremaj
CC:	Donjete Kabashi- Drejtore e DKRSM
NGA/FROM:	Refki Gollopeni- Menagjer për Kulturë
LËNDA/SUBJECT:	

Spektori i Aktiviteteve Kulturore
Refki Gollopeni Menagjer për Kulturë

Gjatë muajit janar janë kryer aktivitete për hartimin e planit dhe programit vjetor për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Në muajin shkurt janë zhvilluar aktivitete kulturore me rastin e kremtimit të Ditës së Pavarësisë. Me këtë rast u mbajt ora poetike-letrare me promovimin e 2 librave të z. Sherif Gashit. U hap ekspozita e artit pamor me krijuesit nga Komuna e Suharekës dhe koncert nga GAM Theranda. Ky aktivitet u

organizua në Shtëpinë e Fellbahut nën përkujdesin e znj. Donjeta Kabashi – drejtoreshë në DKRSM dhe Refki Gollopi, menaxher për kulturë



Në muajin mars u shënuan veprimtaritë kulturore me rastin e shënimit të Ditës së Mësuesit më 7 mars dhe Ditës së Gruas më 8 mars. Aktivitetet u zhvilluan në fushën e artit pamor, letrar dhe muzikor.

Ekspozitën e ka kuruar kuratorja Anita Ramshaj, duke prezantuar artistë vendorë dhe ndërkombëtarë. Në këtë event u recituan poezi për nënën nga z. Sedat Gashi, shkrimtar, dhe znj. Edona Sopaj, aktore, e cila interpretoi bukur edhe këngën “Moj e bukura more”. Programin muzikor e organizoi Artan Elshani – OJQ Aria.



Dita Botërore e Matematikës u shënuar më 14 mars me moton “Art, Matematikë dhe Inovacion”. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me DKRSM, DKA, Shtëpinë e Fellbahut si nikoqire dhe shkollat fillore nga komuna jonë. Në ekspozitë morën pjesë rreth 120 nxënës dhe arsimtarë.

Ky aktivitet u realizua në dy aktivitete: aktiviteti i parë ishte ekspozita kreative, ku shpjegohen fenomenet matematikore përmes artit dhe teknologjisë, ndërsa aktiviteti i dytë ishte simpoziumi shkencor nga inxhinieri dhe matematikienti gjerman Peter Heindorf, Arbër Ibrahim, programer, dhe Emin Hoxha, matematikient

Këtë aktivitet e realizoi këshilli organizativ: prof. Refki Gollopeni, Emin Hoxha dhe Veton Guraziu. Vlen të përmendet që koktejin e ekspozitës e sponsorizoi mërgimtari z. Sadik Zoga

Për të gjithë nxënësit dhe arsimtarët pjesëmarrës janë ndarë mirënjohje për punën dhe angazhimin në këtë aktivitet inovativ me rëndësi për zhvillimin e rinisë.



Dita e viktimave civile më **26 Mars** u shënua vetëm me homazhe te përmendorja e viktimave civile në Suharekë.

Në nderim të **Ushtarit Kavajes**, dëshmorit **Indrit Cara**, në shtëpinë e **Ukë Bytyqit** u realizua pritja e delegacionit nga **Kavaja**. Me këtë rast, grupi **GAM Theranda** ka përgatitur një këngë të re kushtuar **Indrit Carës** për këtë event, ku u rrëfyer kujtimet për të. Kujtimet rrëfeu edhe kryetari i komunës, z. **Bali Muharemaj**, dhe bashkëluftearët nga Brigada 123 në krye me Gjeneral Gzim Hazrolli

Kryetari i **Bashkisë së Kavajës**, z. **Fisnik Qosja**, ishte gjithashtu i pranishëm dhe shprehu respektin e tij ndaj veprës dhe sakrificës së dëshmorit Indrit Cara. Këtë event e madhështoi edhe shoqata e oficerëve Shaiptar Skënderbeu, dhe pjestarë- kadetët e FSK-së që studiojnë në Akadeninë Ushtarake Skënderbeu në Tiranë





Sektori i Rinisë

Me anë të kësaj shkrese ju njoftoj për punët që kam kryer gjatë 3 muajve: Pranimin e kërkesave, ankesave, njoftimeve, faturave dhe shqyrtimin e tyre, takime me OJQ të ndryshme. Kam përfunduar raportin përfundimtar të ojqe- për vitin 2025 të kërkuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit, përcjelljen e aktiviteteve të ndryshme dhe kryerjen e obligimeve financiare nga viti 2025 si dhe pagesa të këtij viti, si dhe punë të tjera me kërkesë të drejtorit.

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Financa në Komunën e Suharekës kanë finalizuar Draft Planin e Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës për periudhën 2026–2029.



Bëhu pjesë e ekipit që e mban Suharekën pastër.



Në shtëpinë e Fellbahut u organizua ekspozita interactive "Udhëtimi i dijes ndër vite", e përgatitur nga mësimdhënësja Lindita Grulaj-Gallopini, aktivitet i realizuar nga nxënësit e Shkollës "7 Marsi" në Suharekë.



ekspozita "Homazh Artistik" në Qendrën Rinore, Shtëpia e Fellbahut në Suharekë, ku artistë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Presheva prezantuan punimet e tyre para artdashësve dhe mysafirëve të shumtë.

Ekspozita solli një atmosferë të veçantë artistike dhe kulturore, duke bashkuar krijues të ndryshëm në një mbrëmje të mbushur me art, bashkëpunim dhe kreativitet. Falënderim për të gjithë artistët, organizatorët dhe pjesëmarrësit që kontribuan në realizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm kulturor.

Homazh Artistik
19 MAJ / MAY 2026

Agnesa Haxhiri – Tetovë, Maqedonia e Veriut
Anila Hetoja – Tiranë, Shqipëri
Arbana Dohari – Tetovë, Maqedonia e Veriut
Arbenita Kërguli – Gjilan, Kosovë
Arbenisha Amari – Tetovë, Maqedonia e Veriut
Arianit Lakca – Prishtinë, Kosovë
Astrit Rexhepi – Tetovë, Maqedonia e Veriut
Avni Zih Behtuli – Gjilan, Kosovë
Beris Bajçeli – Tetovë, Maqedonia e Veriut
Besa Kicaj – Suharekë, Kosovë
Dianeta Kabashi – Prishtinë, Kosovë
Danijeta Kabashi – Suharekë, Kosovë
Elvana Boga Arifi – Ferizaj, Kosovë
Emine Jetaishi – Shitima, Kosovë

Fates Kabashi – Suharekë, Kosovë
Fortesa Boga Arifi – Shitima, Kosovë
Greta Tahirova – Shkoder, Shqipëri
Hyrie Shagiri – Prishtinë, Kosovë
Jalilona Mustafa – Gjilan, Kosovë
Luljeta Rama Maqaj – Prishtinë, Kosovë
Mimusha Daku – Prishtinë, Kosovë
Mora Jashari – Prishtinë, Kosovë
Refik Golepini – Suharekë, Kosovë
Sabri Behramaj – Mitrovicë, Kosovë
Shajrija Fejzullahu – Presheva
Sidica Ismaili – Shkoder, Shqipëri
Valmirë Cikaqi Fejzullahu – Presheva
Vibor Dasti – Tetovë, Maqedonia e Veriut

Qendra për Edukim Kreativ Shtëpia e Fellbahut
Therandë - Republika e Kosovës
18.00 h

ART
GALLERI
MUSEUM

fishbone

Logoja e Komunitetit të Qytetit të Suharekës



“Pranvera Poetike e Therandës”, e organizuar nga Shoqata për Art dhe Kulturë “Elena Gjika – Dora d’Istria”, është aktivitet tradicional ku u mblidhen poetë, krijues dhe dashamirë të fjalës artistike. Me Mirënjohje të veçantë u vlerësuan poezitë: • “Apostull i dritës” – Antika Elshani • “Kur vdes një dashuri” – Gazmend Beqaj • “Sagat bartin dhembje” – Shqipe Hasani • “Qerpikë dëshirash” – Liridon Hyseni • “Takim me poetin” – Qazim Thaçi. Ndërsa, Çmimi “Ragip Sylaj” ju nda poezisë “Mallin tim asgjë s’e ndal”, me autore Hava Muçollari.



Përrurimi i “Kullës së Lirisë” në fshatin Dobërdelan, një projekt me rëndësi historike dhe simbolike për ruajtjen e kujtesës sonë kolektive. Ky projekt u realizua nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë (DKRSM) e Komunës së Suharekës.



Me rastin e 13 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Suharekës, në Shtëpinë e Fellbahut u mbajt aktiviteti kulturor-letrar “Kujtesa e Lirisë”.

Ky aktivitet mblodhi poetë, krijues dhe dashamirë të fjalës së shkruar, të cilët përmes poezisë nderuan dëshmorët dhe vlerat e lirisë.

Në kuadër të aktivitetit u organizua konkursi i poezisë, ku pas vlerësimit nga juria profesionale dhe hapjes së shifrave, u shpallën fituesit e tri çmimeve kryesore:

Vendi i parë – Kastriot Veselaj

Vendi i dytë – Feim Bllaca

Vendi i tretë – Nexhi Baushi



Me rastin e 13 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Suharekës, në Shtëpinë e Kulturës “Ukë Bytyqi” u hap ekspozita me skulptura e artistit Selam Kastrati, e titulluar “Nën lëkurën e gurit”.



Kremtimi i Ditës së Çlirimit dhe ditës së dëshmorëve të komunës së Suharekës u realizua sipas agjendës: Homazhe, Akademi Përkujtimore, parakalimi i veteranëve dhe koncerti festiv.




“Çast” tashmë jeton edhe në hapësirën publike të Suharekës, si një kujtesë që nuk zbehet dhe si një respekt i përhershëm për sakrificën e të mbijetuarve.

Në praninë e Presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, Kryetarit të Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, Ambasadorit të Republikës së Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph, znj. Kadire Tahiraj, znj. Mirlinda Sada, aktivisteve dhe qytetarëve të Suharekës, Fondacioni Jahjaga përmbylli përrurimin e muralit që sjell historinë më afër njerëzve, në zemër të qytetit.

Ky mural bartë mesazhin e kujtesës kolektive, dinjitetit dhe përgjegjësisë për të mos harruar.

Faleminderit Komunës së Suharekës për bashkëpunimin dhe mbështetjen në realizimin e kësaj nisme



Palestra Sportive “13 Qershori” – Suharekë
Periudha: Janar – Shkurt – Mars

Ky raport paraqet aktivitetet sportive dhe organizative të zhvilluara në Palestrën Sportive “13 Qershori” në Suharekë gjatë periudhës tre mujore, duke përfshirë stërvitjet, ndeshjet dhe aktivitetet e klubeve të ndryshme sportive.

- Orari:
 - Çdo ditë nga 10:00 – 22:30
 - 2. Aktivitetet gjatë muajit Janar
 - Stërvitje për grupmoshat:
 - U14, U16, U18
 - KB Ylli
 - Janë zhvilluar:
 - 6 ndeshje të rëndësishme
-

3. Aktivitetet gjatë muajit Shkurt
 - Pjesëmarrës:
 - U14, U16, U18
 - KB Ylli
 - KV Gjinoci (femra)
 - KV Theranda (femra)
 - Janë zhvilluar:
 - 19 ndeshje gjithsej
 - 9 volejboll (femra)
 - 10 basketboll (të gjitha grupmoshat)
 - Stërvitje shtesë:
 - Karate
 - Tekvando
 - FC Futsall “13 Qershori”
-

4. Aktivitetet gjatë muajit Mars

Muaji mars ka qenë gjithashtu shumë aktiv me pjesëmarrje të gjerë të klubeve dhe grupmoshave.

- Kanë zhvilluar stërvitje dhe aktivitet:
 - U14
 - U16
 - U18
 - KB Ylli
 - KV Gjinoci (femra) / KV Gjinoci 94
 - KV Theranda (femra)
 - Ndeshjet e zhvilluara:
Volejboll (femra):
 - Gjithsej 8 ndeshje
- Basketboll (meshkuj – KB Ylli, ekip kampion për grupmoshat):

- U14, U16, U18
- Gjithsej 6 ndeshje

Basketboll – KB Theranda:

- 2 ndeshje

Volejboll – KV Theranda (meshkuj):

- 5 ndeshje

KV Theranda Junior:

- 5 ndeshje

KB Ylli (ekipi i rritur):

- 3 ndeshje

Përfundim

Gjatë periudhës janar, shkurt, mars, Palestra Sportive “13 Qershori” ka qenë në funksion të plotë me një numër të madh aktiviteteve sportive.

- Është shfrytëzuar çdo ditë me orar të zgjatur
- Janë përfshirë shumë klube dhe grupmosha
- Është zhvilluar një numër i konsiderueshëm ndeshjesh në basketboll dhe volejboll

Kjo tregon për një organizim të mirë dhe rol të rëndësishëm të palestrës në zhvillimin e sportit në komunën e Suharekës.

Fatmir Berisha menagjer në palestër.

3 mujorin e dytë në sport është karakterizuar me aktivitete të ndryshme siq janë ushtrimet e rregullta të klubeve në palestër dhe aktivitetet e klubeve me lojrat e rregullta sipas ligave,

Vlen të veqohet aktiviteti i sportit shkollor në nivel regjional Me paraqitje të shkëlqyera dhe shpirt garues, nxënësit e Suharekës dëshmuar edhe një herë se janë lider në sportin shkollor.

Gjimnazi “Jeta e Re” në konkurrencën e femrave dhe IAAP “Skënder Luarasi” në konkurrencën e meshkujve triumfuan denjësisht, duke e renditur Suharekën në krye të garave regjionale.





Në përfundim të garave, ekipet fituese u nderuan me kupa dhe medalje, të cilat u shpërndanë nga drejtoresha e DKRSM-së, znj. Donjete Kabashi.

Një tjetër kupë mbetet në Suharekë!

KV Theranda-F e përmbyll sezonin në mënyrën më të bukur të mundshme, duke triumfuar në finalen ndaj KV Malisheva me rezultat të pastër 3-0 dhe duke u shpallur kampione!



Gjimnazi “Jeta e Re” – Kampion i Kosovës në volejboll!

Në kuadër të gjimnaziadës “Peja 2026”, e cila u zhvillua në qytetin e Pejës me pjesëmarrjen e shkollave më të mira nga e gjithë Kosova, ekipi i vajzave të gjimnazit “Jeta e Re” ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm duke u shpallur kampion!



Garat komunale në voleyboll për SHFMU, në konkurrencën e femrave dhe meshkujve. U përcaktuan ekipet fituese që do të vazhdojnë në garat regjionale. Rezultatet ishin këto: SHFMU – femrat, "7 Marsi" "Gj.K. Skënderbeu"
SHFMU – meshkujt "7 Marsi" dhe "Edit Durham"



Më 03.05.2026 (e diel), Federata e Triathlonit e Kosovës organizoi Kampionatin e Kosovës në Sprint Duathlon për kadetë (vajza dhe meshkuj), i cili u mbajt në Komunën e Vushtrrisë.
Gara u zhvillua në formatin: 2.5 km vrap 🏃, 9 km biçikletë 🚲 dhe 1.25 km vrap 🏃.

Nerënxa Kuçi, edhe një herë e jashtëzakonshme, u shpall kampione absolute e Kosovës në konkurrencën e kadetëve me rezultat (37:29)

Bleard Gashi u shpall nënkampion i Kosovës në kategorinë e kadetëve, duke konfirmuar nivel të lartë performance, me rezultat (34:51)

Eris Kabashi u rendit në mesin e tre më të mirëve në këtë kampionat, duke vulosur suksesin e ekipit tonë, me rezultat (39:45)



Rezultate të shkëlqyera nga të rinjtë tanë në Shkup!

🥈 Selina Gashi – vendi i dytë, 🥈 Nerënxa Kuçi – vendi i dytë dhe 🥉 Bleard Gashi – vendi i tretë

Këto suksese tregojnë qartë potencialin dhe përkushtimin e rinisë sonë. Do të vazhdojmë t'i mbështesim drejt arritjeve edhe më të mëdha.



Garuesit nga komuna e jonë moren pjesë dhe arriten sukses në garat ndërkombëtare off-road të mbajtura në Rozhajë, me pjesëmarrje nga disa shtete të rajonit. Hysni Luzhnica (Off-Road Malësia) u rendit në vendin e dytë, vetëm 3 sekonda pas vendit të parë, pas një performance të shkëlqyer në pistë. Leomir Tafaj (Off-Road Gerikoci) arriti vendin e tretë, duke kompletuar suksesin e garuesve tanë. Këto rezultate janë dëshmi e përkushtimit dhe përfaqësimit dinjitoz të komunës sonë në këtë sport.




Në palestrën "13 Qershori" në Suharekë, u zhvilluan garat e regjionit të Prizrenit në volejboll për SHFMU, në konkurrencën e femrave dhe meshkujve. Në këtë aktivitet sportiv morën pjesë shkollat nga Prizreni, Suhareka dhe Malisheva. Rezultatet: Femrat "17 Shkurti" - Banjë, Malishevë "7 Marsi" – Suharekë. Meshkujt "Ismail Qemali" - Bellanice, Malishevë "Bajram Curri" - Romajë, Prizren



Turneu tradicional në Studençan u organizua nga Këshilli Organizativ i Studençantit, në nderim të Dëshmorëve të Kombit, duke bashkuar sportin me kujtimin dhe respektin përdëshmorët e lirisë. Turneu u përkrah nga Komuna e Suharekës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë në Suharekë



FC Ballkani U19 – Kampionë të Kosovës!



Në shënim të 1 Qershorit, Ditës së Fëmijëve, u zhvillua aktiviteti “Futboli na Bashkon”, i organizuar nga Federata e Futbollit e Kosovës, Lidhja Rajonale e Futbollit e Prizrenit dhe Komuna e Suharekës përmes DKRSM-së



Më 14 Qershor u bë hapja e Turneut Tradicional “Sadik Ramadanaj” në Sopijë të Suharekës. Ky turnir mbledhi një numër të madh sportdashësish, duke krijuar një atmosferë të jashtëzakonshme me energji, entuziazëm dhe frymë sportive. Të pranishmit patën mundësinë të shijojnë ndeshje cilësore dhe një organizim të mirëfilltë, duke e bërë këtë aktivitet një festë të sportit dhe bashkimit të komunitetit. Turneu “Sadik Ramadanaj” vazhdon të mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme sportive në zonë, duke promovuar talentin, garën e ndershme dhe dashurinë për futbollin



FC Suhareka U-9 fiton titullin kampion në Teuta Cup 2026!

Komuna e Suharekës shpreh urimet më të sinqerta për grupmoshën U-9 të FC Suhareka, e cila u shpall kampione e turnirit Teuta Cup 2026, pas një paraqitjeje të shkëlqyer dhe një finaleje mjaft emocionuese ndaj SHF Hisaret.

Ky sukses është rezultat i punës së palodhshme, përkushtimit dhe talentit të lojtarëve, si dhe angazhimit të trajnerëve dhe mbështetjes së vazhdueshme të prindërve.

Përgëzime të veçanta për trajnerin Dren Morina për kontributin e tij në zhvillimin dhe suksesin e ekipit.



FC Ballkani U11 fiton titullin kampion!

Me paraqitje të shkëlqyera dhe angazhim maksimal, ekipi U11 i FC Ballkanit kurorëzoi me sukses një garë cilësore, duke dëshmuar talent dhe shpirt fitues.



Trashëgimia Kulturore

Nga: Nazif Demiraj, Zyrtar për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv

Raporti tremujor, 2026

Gjatë javës që kaluam, në Muzeun e Qytetit janë zhvilluar disa aktivitete për nder të festës së Pavarësisë së Kosovës.

Gjithashtu është realizuar edhe një emision për RTK-në, me gazetaren Teuta Mujaj.

Gjithashtu kam pasur disa takime edhe me arkeologun Dr. Shafi Gashi, lidhur me një projekt për një ekspozitë dhe rregullimin e disa problemeve që janë evidente në muze, dhe njëkohësisht botimin e një katalogu për artefaktet e Hisarit.

Gjatë kësaj jave në muze ishte edhe drejtoresha e DKRSM-së, znj. Donjete Kabashi.

Vizita e parë është realizuar nga dy klasa të VI-ta të SHFMU “Dituria”, Samadrexhë, me mësues Muharrem Kotorri.

Gjatë kësaj kohe, për një orë, sipas planprogramit që ata kanë dhe lidhshmërisë së aktivitetit, ju kam ligjëruar për historikun e muzeut dhe rëndësinë që ka ky institucion si pasuri e jona e lashtë e trashëgimisë arkeologjike dhe historike.



F1.SHF.MU "Dituria", Samadrexhë Peganit



F.2. ligjerat mbi Stellen e



F.3. Pjese nga aktiviteti shume I mire.



F.4. Interesimi I femijeve ishte

Vizita tjetër e radhës ka qenë nga nxënësit e SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Sallagrazhdë.

Këta fëmijë ishin veshur me veshje kombëtare dhe të UÇK-së, dhe kjo përkonte me datën e Pavarësisë së Kosovës. Përpos fotove që u shkrepën, me vizitorët biseduam edhe për këtë pjesë të historisë më të re të Kosovës dhe mundin dhe sakrificën që është bërë për të fituar lirinë.



F.5. SHFMU "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" – Sallagrazhe



*F.6. Vajzat me veshje kombetare
UÇK-së*



F.7 Femijet me uniforma te

Vizita tjetër e radhës ishte nga parashkollorët e qytetit “Fluturat”, të cilët kishin përgatitur disa këngë dhe recitale që lidhen me datën e 17 shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Këto aktivitete i kemi postuar edhe në faqen e muzeut, sipas aktiviteteve.



*F.8. JP “Fluturat”, Suhareke
Femijet me flamur te Kosoves*



F.9. Dhurat nga femijet



F.10. 3 Fluturat



F.11.

Përmbledhje e aktiviteteve – Muzeu i Qytetit

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa takime me arkeologun Dr. Shafi Gashi lidhur me një projekt për hapjen e një ekspozite në Muze, që parasheh sjelljen e artefakteve nga lokalitetet e komunës sonë (Hisari, Reshtani dhe Kasteci), si dhe rregullimin e hapësirave ekspozuese.

Është bërë riorganizimi i ekspozitave, duke sistemuar punimet në hapësirat përkatëse.

Është bërë edhe vizitë në Kalanë e Prizrenit për të parë nga afër mënyrën e organizimit të ekspozitave, si model për zhvillimin e mëtejshëm të Muzeut në Suharekë.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë aktivitete për pastrimin dhe rregullimin e ambientit të Muzeut, si brenda ashtu edhe jashtë, me mbështetjen edhe të organizatës “Eko Regjioni”.

Megjithëse projekti për zhvillimin e Muzeut ka potencial të madh, mungesa e mbështetjes institucionale mbetet sfidë për realizimin e tij.



F.12. Eko regjioni - Pastimi i pjeseve te betonuara me uje. me uje



F.13. Larja pllato

Më 25.02.2026, Florim Bytyqi nga Kravasaria, me banim në Suharekë, ka sjellë disa gazeta të viteve të para të luftës së fundit dhe të pasluftës për t'u ruajtur si dokumentacion në muze.

Më 27.02.2026, SHFMU "Dituria", Samadrexhë, ka realizuar vizitë në muze me nxënësit e klasave I-1 dhe II-1, të shoqëruar nga mësueset Sherife Shala, Ruzhdi Hoti dhe Bukuriye Shukaj.

Më 03.03.2026, muzeun e vizituan dy qytetarë nga Samadrexha, ish-pjesëtarë të UÇK-së, z. Fazli Spahiu dhe Mursel Zeqaj, të cilët evokuan kujtime nga lufta dhe nga shokët e tyre dëshmorë.



F.16.. Dy pjesëtar te UÇk-së gjate vizites ne muze. kl.X-1



*F.17. Prof. Xhavit Basha, nxenesit
(SH.P. Abdyl Rama, Shiroke)*

Me 05.03.2026 nxenesit e SHP Abdyl Ramaj - Shiroke , drejtimi Teknologji Ushqimore X-1 se bashku me profesorin e tyre Xhavit Basha per nje ore zhvilluan bisedime rreth Muzeut dhe artefakteve qe gjenden ne te duke shfaqur nje interesim te jashtzakonshem.

Gjatë muajit mars kam zhvilluar disa takime me kryetarin e Shoqatave të Dala nga Lufta, kryetarin e veteranëve, si dhe me veteranë nga fshati Samadrexhë dhe familjarë të dëshmorit Vani Hodaj. Për këto aktivitete jeni në dijeni ju dhe kryetari.

Më 11.03.2026, drejtoresha e Kulturës, së bashku me zyrtarin Nazif Demiraj, realizuan vizitë në Kalanë e Prizrenit, ku u takuan me drejtorin e kalasë, dr. Shafi Gashi, arkeolog.



F.18. Artefaktet që gjenden në kalan e Prizrenit, një pjesë e madhe e komunes së Suharekës.



*F.19. Ekspozitura e artefakteve.
Donjeta Kabashi-Krasniqi, Nazif Demiraj*



F.20. Dr. Shafi Gashi, DKRS M



F.21. Refki Hodaj, Rifat jollxjiu, Alban Berisha, Nazif Demiraj

Disa ditë kemi punuar me djalin në rregullimin e disa materialeve dhe fotove që ndodheshin në pjesën e përdorur si depo arkivi nga vitet e mëparshme. Kemi bërë sistemimin, ndarjen dhe pastrimin e dhomës ku ruhen këto materiale.

Më 17.03.2026, gjatë muajit mars, e kisha në vizitë edhe ish-drejtorin e Shërbimeve Pronësore, Juridike dhe Kadastër, z. Emrush Bytyqi, së bashku me dy vajzat e tij, të cilët shprehën admirim për muzeun.



F.24.. Emrush Bytyqi me vajzat - Mushtisht



F.25. Pa koment

Sigurisht që gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe vizita individuale të qytetarëve dhe forma tjera të komunikimeve por përgjithsisht theksova disa prej tyre.

Në kuadër të ekspozitës "Foto dokumente nga arkivat dhe literatura shkencore për Gjergj Kastrioti-Skenderbeu, Profesor Fadil Bytyqi autori i ekspozitës i dhuroi 5 fotografi dokumentare për fondin e muzeut të qytetit.



ZLTKA
Nazif Demiraj



RAPORT TREMUJOR I AKTIVITETEVE Janar – Shkurt – Mars 2026

Ky raport përfshin aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2026. Dokumenti është përgatitur për qëllime raportimi zyrtar ndaj komunës dhe donatorëve.

Aktivitetet – Janar 2026

Gjatë muajit Janar 2026, në Shtëpinë e Kulturës “Uke Bytyqi” nuk është realizuar asnjë aktivitet publik.

Megjithatë, stafi i institucionit ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në mirëmbajtjen e objektit, përgatitjen teknike të hapësirave dhe organizimin e brendshëm, me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve në muajt në vijim.

Aktivitetet – Shkurt 2026

Gjatë muajit Shkurt 2026 janë realizuar gjithsej 6 aktivitete, të zhvilluara në periudhën nga 13 Shkurt deri më 27 Shkurt, si në vijim:

- Xhirimi i një broadcasti të realizuar nga Prof. Meriton Kabashi nga Shkolla Teknike “Skënder Luarasi”
- Program festiv i organizuar nga kopshti i fëmijëve “Melodia”
- Xhirimi i një spoti në ambientet e jashtme të Shtëpisë së Kulturës
- Program edukativ i realizuar nga institucioni “School for Life”
- Ofrimi i shërbimeve të zërimit në Shkollën “17 Shkurti” në Shirokë

Aktivitetet – Mars 2026

Gjatë muajit Mars 2026 janë realizuar gjithsej **11 aktivitete**, ndër të cilat veçohen:

- Performancë artistike nga nxënësit e Shkollës Fillore Bukosh, nën udhëheqjen e Adelina Ismail Sopa
- Organizimi i aktivitetit me rastin e Ditës së Shkollës Fillore “7 Marsi”
- Aktivitet festiv nga kopshtet e fëmijëve me rastin e Ditës së Mësuesit
- Ekspozitë e organizuar nga DKRS në bashkëpunim me mërgatën
- Konferencë e organizuar nga QBS
- Shfaqje e një dokumentari nga Kryqi i Kuq – Suharekë
- Ofrimi i shërbimeve të zërimit jashtë objektit të Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi”

Këto aktivitete kanë pasur një pjesëmarrje të konsiderueshme dhe kanë ndikuar në promovimin e kulturës, edukimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në komunitet.

Këto aktivitete kanë kontribuar në gjallërimin e jetës kulturore dhe edukative, si dhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe organizatat lokale.

Përmbledhje

Gjatë këtij tremujori janë realizuar aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike, duke ndikuar pozitivisht në jetën kulturore të qytetit

Në trmujorin e dytë u organizuan shumë aktivitete Kulturore dhe argëtuese që u mbajtën në Shëpinë e Kulrurës

. Teatri Kombëtar i Kosovës vjen në Suharekë me komedinë e njohur “ART” nga Yasmina Reza, me regji të Bashkim Ramadanit.



Ekspozita “Riciklo , krijo Artne” në ambientet e Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë, u mbajt aktiviteti “Riciklo, krijo art”, një ekspozitë e veçantë kushtuar rinisë, në shënim të Ditës së Tokës.

Ky aktivitet u realizua me mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës.

Në këtë ngjarje morën pjesë disa shkolla nga Komuna e Suharekës, të cilat prezantuan punime kreative dhe mjaft inspiruese, të realizuara nga materiale të riciklueshme.

Në kuadër të aktivitetit u ndanë katër çmime:

Vendi i parë: SHFMU “Kongresi i Manastirit” Studençan dhe SHFMU “Destan Bajraktari” Suharekë

Vendi i dytë: SHFMU “Hasan Prishtina” Semetisht

Vendi i tretë: SHFMU “Xhavit Sylaj” Sllapuzhan



Në Shtëpinë e Kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë, në kuadër të shënimit të ditëlindjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeu, u shfaq dokumentari i veçantë kushtuar Donika Kastrioti, me titull “Andronica una Principessa Europea”. Ky film i realizuar nga regjisori Ylli Pepo, solli një rrëfim të ndjerë për jetën, forcën dhe dinjitetin e Donikës, duke e paraqitur atë si një figurë të denjë dhe një nga gratë më të rëndësishme të historisë sonë, pranë Skënderbeut.

Falënderojmë përzemërsisht regjisorin Ylli Pepo, skenaristin Martin Cukalla, aktoren Daniela Sulko në rolin e Donikës, si dhe Lindita Ngresi për kontributin në realizimin e filmit.



Në ambientet e Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë, u hap ekspozita “Foto dokumente nga arkivat dhe literatura shkencore për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun”, në shënim të 621-vjetorit të datëlindjes së tij. Prof. Fadil Bytyçi prezantoi dokumente të rralla dhe mjaft të veçanta, duke sjellë dëshmi të çmuara mbi jetën dhe veprimtarinë e heroit kombëtar. Ekspozita ofron një udhëtim të pasur historik përmes materialeve arkivore dhe literaturës shkencore, duke rikthyer në vëmendje figurën madhështore të Skënderbeut dhe rolin e tij të pazëvendësueshëm në historinë dhe identitetin tonë kombëtar.



Përgatiti:
Shpejtim NDRECAJ
Përgjegjësi i Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyqi”

BIBLIOTEKA E QYTETIT “HAJDIN BERISHA”

Gjatë tre muajve (janar-mars), biblioteka ka organizuar një sërë aktivitetesh që kanë pasuruar jetën kulturore të komunitetit dhe kanë forcuar ndërveprimin me lexuesit.

PROMOVIMET E LIBRAVE:

Shtëpia botuese “Dukagjini” organizoi promovimin e lektyrave shkollore për nxënësit e klasave të parë deri në klasën e pestë. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan botimet më të reja, të cilat synojnë të mbështesin procesin mësimor dhe zhvillimin arsimor të nxënësve në ciklin fillor.



Fotografia I-rë: Promovimi i lektyrave shkollore nga shtëpia botuese Dukagjini Autori Tahir Musaj promovoi dy libra. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan:

- Libri me poezi “*Me buzëqesh agu i mëngjesit*” ;
- Romani “*Pas stuhisë lind dielli përsëri*”.



Fotografia e II-të: Ballinat e dy librave të autorit Tahir Musaj

VIZITAT:

Udhëheqësja e Bibliotekës “Hajdin Berisha”, Arbenitë Hoxha Ramaj së bashku me zyrtarët e bibliotekës, Ramiz Selimaj dhe Shpresa Berisha, realizuan një vizitë zyrtare në Bibliotekën e Rahovecit “Sulejman Krasniqi”. Gjatë kësaj vizite, ata u pritën nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. At dhe Rama, si dhe nga Udhëheqësi i Bibliotekës, z. Luan Danuza. Në kuadër të takimit u diskutua për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitutional, me fokus të veçantë në promovimin e librit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe fuqizimin e rolit të bibliotekave në komunitet.



Fotografia III-të: Vizita në Bibliotekën e Rahovecit

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, së bashku me dy klubet e leximit, u realizua një vizitë studimore në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrësit

patën mundësinë të njihen nga afër me ambientet e institucionit, organizimin e fondit libror, si dhe me rolin dhe rëndësinë e bibliotekës në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Kjo vizitë kontribuoi në rritjen e interesimit për leximin, si dhe në thellimin e njohurive mbi funksionimin dhe rëndësinë e institucioneve bibliotekare në shoqëri.



Fotografia e IV-të: Vizita e klubeve të leximit në Bibliotekën Kombëtare

Biblioteka jonë u vizitua nga nxënësit e klasës së gjashtë të SHFMU “Dituria” nga fshati Samadrexhë, të shoqëruar nga mësuesi i tyre, z. Muharrem Kotorri. Gjatë kësaj vizite, nxënësit patën mundësinë të njihen nga afër me fondin libror, mënyrën e funksionimit të bibliotekës, si dhe me rëndësinë e leximit në zhvillimin e tyre personal dhe arsimor.



Fotografia e V-të: Vizita e nxënësve të fshatit Samadrexhë në bibliotekë tonë

AKTIVITETE TJERA:

Në kuadër të aktivitetit “Përrallat na bashkojnë”, u realizua një aktivitet me fëmijët parashkollorë të Institucionit Parashkollor “Flutrat”, gjatë të cilit ata rrëfyen përrallat e lexuara së bashku me prindërit e tyre. Në shenjë mirënjohjeje për pjesëmarrjen dhe angazhimin, secili fëmijë u shpërblye me certifikatë. Ky

aktivitet krijoi një atmosferë të ngrohtë bashkëpunimi ndërmjet fëmijëve dhe prindërve, duke nxitur njëkohësisht zhvillimin e dashurisë për librin dhe leximit që në moshë të hershme.



Fotografia e VI-të: Aktiviteti “Përrallat na bashkojnë”

“Çka do të thotë liria e Kosovës për mua?” ishte tema që u diskutua me dy klubet e leximit, për nder të 18-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Tri gjenerata u bënë bashkë në një bisedë të hapur dhe plot emocion: ata që përjetuan luftën dhe humbën familjarët e tyre, gjenerata e dytë që e mban mend luftën si fragmente kujtimesh dhe gjenerata e tretë që e gëzon lirinë si realitet të përditshëm.

Secila solli mendime, përjetime dhe reflektime të thella mbi sakrificën, dhimbjen, shpresën dhe përgjegjësinë që kemi për ta ruajtur dhe forcuar lirinë.



Fotografia e VII-të: Diskutimi “Çka do të thotë liria e Kosovës për mua?”

Brenda kësaj periudhe janë realizuar tri takime të përbashkëta ndërmjet klubeve të leximit “Zgjimi” dhe “Bota e Leximit”. Gjatë këtyre takimeve, pjesëmarrësit kanë zhvilluar diskutime mbi tema të ndryshme letrare, duke përfshirë analizën e veprave të lexuara, shkëmbimin e mendimeve dhe promovimin e kulturës së leximit.

Takimet janë karakterizuar nga pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim konstruktiv ndërmjet anëtarëve të të dy klubeve, duke kontribuar në rritjen e interesimit për librin dhe zhvillimin e shprehive të leximit kritik.

RAPORTI STATISTIKOR

Gjatë periudhës Janar–Mars 2026, “Biblioteka Hajdin Berisha” ka realizuar me sukses misionin e saj në ofrimin e shërbimeve bibliotekare për lexuesit dhe komunitetin në përgjithësi, duke dëshmuar një angazhim të vazhdueshëm në promovimin e leximit dhe kulturës.

Të dhënat statistikore për këtë periudhë janë si më poshtë:

<i>Sektori / Përshkrimi</i>	<i>Numri</i>
<i>Numri i përgjithshëm i lexuesve të regjistruar</i>	534
<i>Numri i përgjithshëm i librave të lexuar</i>	1536
<i>Sektori i Fëmijëve – Lexues të regjistruar</i>	367
<i>Sektori i Fëmijëve – Ndërrime të librave</i>	885
<i>Sektori i të Rriturve – Lexues të regjistruar</i>	167
<i>Sektori i të Rriturve – Ndërrime të librave</i>	651
<i>Salla e Leximit – Përdorues</i>	782

Gjatë Janar–Mars 2026, Biblioteka e Qytetit “Hajdin Berisha” ka realizuar të hyra financiare në vlerë prej 468 euro. Të gjitha mjetet e inkasuara janë dorëzuar dhe barazuar në zyrat përkatëse, në kuadër të Drejtorisë së Financave, në përputhje me procedurat dhe rregullat financiare në fuqi.

RAPORTI I PËRPUNIMIT TË LIBRAVE DHE I SHËRBIMEVE Biblioteka ka zhvilluar dhe zbatuar praktika të mirëfillta profesionale në fushën e përpunimit të librit dhe ofrimit të shërbimeve bibliotekare:

- Menaxhimi financiar dhe administrimi i mjeteve materiale të siguruar nga participimi;
- Përpunimi i librave të dhuruar, përfshirë:
 - Caktimin e signaturave sipas sistemit KUD
 - Regjistrimin në libër inventari
- Shërbimet për lexuesit:
 - Ndërrimi i librave dhe konsultimi;
 - Ofrimi i informacionit dhe orientimit;
 - Mbikëqyrja e aktivitetit brenda ambienteve të bibliotekës.
- Kujdes i veçantë ndaj librave të humbur dhe zëvendësimi i tyre;

Suharekë, 2026

Udhëheqësja e Bibliotekës së Qytetit “Hajdin Berisha”
Arbenitë Hoxha Ramaj

RAPORTI I PUNËS PËR TREMUJORIN E DYTË
(PRILL-QERSHOR 2026)
BIBLIOTEKA E QYTETIT “HAJDIN BERISHA”

Gjatë tre muajve (Prill-Qershor), biblioteka ka organizuar një sërë aktiviteteve që kanë pasuruar jetën kulturore të komunitetit dhe kanë forcuar ndërveprimin me lexuesit.

PROMOVIMET E LIBRAVE:

Autorja Leonida Maliqi ka promovuar librin me poezi “Dritë nën hijet e ditëve”. Promovimi i librit paraqiti një mundësi për prezantimin e krijimtarisë së autores së re Leonida Maliqaj para publikut. Përmes veprës së saj poetike u prezantuan tema dhe refleksime të ndryshme, ndërsa aktiviteti kontribuoi në nxitjen e interesimit për letërsinë dhe mbështetjen e talenteve të reja krijuese.



Fotografia 1: Autorja Leonida Maliqi gjatë promovimit të librit.

Në Bibliotekën e Qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë u promovua libri me titull “Mjekësia e Suharekës” – monografi e autorit Dr. Bajram Basha.

Vepra paraqet një pasqyrë të historisë dhe zhvillimit të shërbimeve shëndetësore në Suharekë, duke dokumentuar kontributin dhe angazhimin e mjekëve dhe profesionistëve shëndetësorë ndër vite. Përmes të dhënave, dëshmive dhe materialeve të përmbledhura, libri ofron informacion të rëndësishëm për zhvillimin e mjekësisë në komunë dhe shërben si një burim me vlerë për studiuesit, profesionistët dhe qytetarët.



Fotografia e II-të: Libri Mjekësia e Suharekës nga autori Bajram Basha.

Në ambientet e Bibliotekës së Qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë u mbajt promovimi i librit “Populli ynë” – “Nga zëri i një 14-vjeçareje”, me autore Eliza Grulaj.

Gjatë aktivitetit u prezantua përmbajtja e veprës, përmes së cilës autorja trajton tema që lidhen me historinë, popullin dhe identitetin kombëtar nga këndvështrimi i një të reje.



Fotografia e III-të: Autorja Eliza Grulaj gjatë promovimit të librit.

VIZITAT:

Drejtoresha e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës, znj. Donjete Kabashi së bashku me stafin e bibliotekës dhe anëtarët e Klubeve të Leximit, shkrimtarë, lexues dhe bashkëpunëtorë vizituan Bibliotekën “Gjergj Fishta” në Lezhë dhe institucione të tjera kulturore, si Galerinë e Artit, Muzeun Etnografik, Obeliskun dhe Memorialin e Vendvarrimit të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.



Fotografia e IV-të: Vizita në Lezhë.

Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për njohje, shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit kulturor ndërmjet institucioneve tona.

Gjatë kësaj periudhe, Biblioteka e Qytetit “Hajdin Berisha” priti në vizitë nxënësit e shkollave të ndryshme. Këto janë shkollat që kanë ardhur për vizitë:

- Shkolla Filllore “17 Shkurti” nga Shiroka;
- Shkolla Filllore “7 Marsi” nga Suhareka;
- Shkolla Filllore “Destan Bajraktari” nga Suhareka;
- Shkolla Filllore “Shkëndija” nga Suhareka;
- Shkolla e Mesme Profesionale “Abdyl Ramaj” nga Suhareka;
- Shkolla Filllore “Iliria” nga fshati Savrovë;
- Shkolla Filllore “Hasan Prishtina” nga fshati Semetisht;
- Shkolla Filllore “Shaban Mazreku” nga fshati Sopijë;
- Shkolla Filllore “Dëshmorët e Greikocit” nga fshati Greikoc;
- Shkolla Filllore “Dëshmorët e Kombit” nga fshati Vraniq.



Fotografia e V-të: Vizita e nxënësve në Bibliotekën e Qytetit “Hajdin Berisha”



Fotografia e VI-të: Vizita e nxënësve në Bibliotekën e Qytetit “Hajdin Berisha”

AKTIVITETE TJERA:

Në kuadër të aktivitetit “Përrallat na bashkojnë”, u realizua një aktivitet me fëmijët parashkollorë të Shkollës Fillore “Destan Bajraktari” gjatë të cilit ata rrëfyen përrallat e lexuara së bashku me prindërit e tyre. Në shenjë mirënjohjeje për pjesëmarrjen dhe angazhimin, secili fëmijë u shpërblye me certifikatë. Ky aktivitet krijoi një atmosferë të ngrohtë bashkëpunimi ndërmjet fëmijëve dhe prindërve, duke nxitur njëkohësisht zhvillimin e dashurisë për librin dhe leximit që në moshë të hershme.



Fotografia e VII-të: Aktiviteti “Përrallat na bashkojnë”

Dy klubet e leximit zhvilluan një diskutim të përbashkët me temën: “A mund të ndryshojë libri jetën tuaj?”, për nder të Ditës së Librit.

Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit ndanë mendimet dhe përvojat e tyre mbi ndikimin që librat kanë në formimin personal, në zgjerimin e dijes dhe në ndryshimin e këndvështrimeve për jetën. Diskutimi u karakterizua nga ide frymëzuese dhe reflektime të thella, duke theksuar rolin e rëndësishëm të librit si një udhërrëfyes në zhvillimin individual dhe shoqëror.



Fotografia e VIII-të: Diskutimi “A mund të ndryshojë libri jetën tuaj?”, për nder të Ditës së Librit.

Brenda kësaj periudhe janë realizuar tri takime të përbashkëta ndërmjet klubeve të leximit “Zgjimi” dhe “Bota e Leximit”. Gjatë këtyre takimeve, pjesëmarrësit kanë zhvilluar diskutime mbi tema të ndryshme letrare, duke përfshirë analizën e veprave të lexuara, shkëmbimin e mendimeve dhe promovimin e kulturës së leximit.

Takimet janë karakterizuar nga pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim konstruktiv ndërmjet anëtarëve të të dy klubeve, duke kontribuar në rritjen e interesimit për librin dhe zhvillimin e shprehive të leximit kritik.

DONACIONET

Në kuadër të mbështetjes dhe bashkëpunimit me komunitetin, Biblioteka e Qytetit ka pranuar një donacion të vlefshëm nga lexueset tona të dalluara, Eliza dhe Inara Gualaj.

Donacioni përfshin pajisje teknologjike: një laptop dhe një printer/skaner, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve bibliotekare, lehtësimin e punës administrative dhe krijimin e kushteve më të mira për përdoruesit e bibliotekës.



Fotografia e IX-të: Dhurimi i pajisjeve teknologjike nga lexuesit tanë

Një falënderim i veçantë i drejtohet Fabrikës së Mobileve “Te Naseri”, përkatësisht z. Naser Gashi, i cili ka mbështetur financiarisht realizimin e vizitës në Lezhë.

RAPORTI STATISTIKOR

Gjatë periudhës Prill–Qershor 2026, “Biblioteka Hajdin Berisha” ka realizuar me sukses misionin e saj në ofrimin e shërbimeve bibliotekare për lexuesit dhe komunitetin në përgjithësi, duke dëshmuar një angazhim të vazhdueshëm në promovimin e leximit dhe kulturës.

Të dhënat statistikore për këtë periudhë janë si më poshtë:

<i>Sektori / Përshkrimi</i>	<i>Numri</i>
<i>Numri i përgjithshëm i lexuesve të regjistruar</i>	159
<i>Numri i përgjithshëm i librave të lexuar</i>	1588
<i>Sektori i Fëmijëve – Lexues të regjistruar</i>	109
<i>Sektori i Fëmijëve – Ndërrime të librave</i>	962

Sektori i të Rriturve – Lexues të regjistruar
Sektori i të Rriturve – Ndërrime të librave

50
626
1019

Salla e Leximit – Përdorues

Gjatë Prill–Qershor 2026, Biblioteka e Qytetit “Hajdin Berisha” ka realizuar të hyra financiare në vlerë prej 601 euro. Të gjitha mjetet e inkasuara janë dorëzuar dhe barazuar në zyrat përkatëse, në kuadër të Drejtorisë së Financave, në përputhje me procedurat dhe rregullat financiare në fuqi.

RAPORTI I PËRPUNIMIT TË LIBRAVE DHE I SHËRBIMEVE

Biblioteka ka zhvilluar dhe zbatuar praktika të mirëfillta profesionale në fushën e përpunimit të librit dhe ofrimit të shërbimeve bibliotekare:

- Menaxhimi financiar dhe administrimi i mjeteve materiale të siguruara nga participimi;
- Përpunimi i librave të dhuruar, përfshirë:
 - Caktimin e signaturave sipas sistemit KUD
 - Regjistrimin në libër inventari
- Shërbimet për lexuesit:
 - Ndërrimi i librave dhe konsultimi;
 - Ofrimi i informacionit dhe orientimit;
 - Mbikëqyrja e aktivitetit brenda ambienteve të bibliotekës.
- Kujdes i veçantë ndaj librave të humbur dhe zëvendësimi i tyre;

Suharekë, Qershor 2026

Udhëheqësja e Bibliotekës së Qytetit “Hajdin Berisha”
Arbenitë Hoxha Ramaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E SUHAREKËS

OPSTINE SUVA REKA

THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë

Datë:

10Nr.

Duke u bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave NR.-04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, bazuar në vendimin me numer protokoli **01-Nr.410-22805** të datës **18.05.2026** për formim të komisionit për vlerësimin e projekteve të dorëzuara nga OJQ-të, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

VENDIM

PËRFUNDIMTAR PËR SUBVENCIONIMIN E OJQ-VE

Në përputhje me afatet dhe detyrta e komisionit të përcaktuar në vendimin e lartë përmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datë **14.04.2026** me tematike kulturë, rini, sport, komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve komisioni vlerësues ka shpallur Listën Përfundimtare të përfituesve për subvencionim të këtyre OJQ-ve:

Emri i ojq-ve

	Përfituesi	Titulli i projektit	Fusha
1.	10-181-18734	Masovizimi i sportit të Motoçiklizmit Enduro	Sport

2.	10-181-22172	Festari –PGA-Suhareka Open 2026	Sport
3.	10-181-21054	Organizimi i Garave në Offroad në kuadër të ditëve të Mërgatës dhe Festari 2026	Sport
4.	10-181-19072	Zhvillimi dhe avancimi i sportit në Komunën e Suharekës me theks të veçantë në zhvillimin e Triathlonit	Sport
5.	10-181-19433	Zhvillimi i kampionatit 2026/2027 në kuadër të Federatës së Karates së Kosovës	Sport
6.	10-181-20854	Zhvillimi dhe Fuqizimi i Volejbollit të meshkujve përmes trajnimit dhe pjesëmarrja në gara kombetare dhe ndërkombëtare	Sport
7.	10-181-20044	Zhvillimi dhe promovimi i Bjeshkatarisë dhe Turizimit Malor në Komunën e Suharekes	Sport
8	10-181-20288	Organizimi dhe Pjesëmarrja e Klubit të Automotos “Motosport Theranda”	Sport
9.	10-181-21650	Zhvillimi dhe promovimi i Motoçiklizmit për të rinjë në Komunën e Suharekës	Sport
10.	10-181-21022	Klubi i Futbollit Suhareka 23, mundësi e mirë për angazhimin e të rinjëve në aktivitete sportive	Sport
11.	10-181-20861	Fuqizimi i vajzave përmes volejbollit : Trajnim , zhvillim dhe përfaqësim në gara zyrtare	Sport
12.	10-181-20884	Zhvillimi i kampionatit në kuadër të Federatës së Basketbollit të Kosovës me ekipin senior dhe grupmoshat e reja sezona 2026/2027	Sport
13.	10-181-22001	Zhvillimi i kampionatit në kuadër të Federatës së Volejbollit me senior dhe grupmoshat e reja 2026/2027	Sport
14.	10-181-20751	Zhvillimi i 2026/2027 sezona vjeshtore ne kuadër të FFK – Liga e Tretë e futbollit rajoni i Dugagjinit	Sport
15.	10-181-18801	Pjesëmarrja në gara në kuadër të FFK të lidhjes rajonale në Futboll	Sport
16.	10-660-18106	Promovimi i talentëve të rinjë	Sport
17.	10-181-21029	Pjesëmarrja në gara të Superligës së Futsallit të Kosovës	Sport
18.	10-181-19727	Zhvillimi dhe promovimi i futsallit në Komunën e Suharekës	Sport

19.	10-181-20586	Atletika pa barriera –Pjesëmarrja në gara vendore dhe ndërkombëtare	Sport
20.	10-181-20457	Zhvillimi i 2026/2027 sezona pranverore në kuadër të LRF-Prizren dhe pjesëmarrja në turnirin mbarëkombëtarë Ulipana Cup në Durrës	Sport
21.	10-181-20230	Zhvillimi i lojës së Shahut –aktivitete promovuese dhe garuese	Sport
22.	10-181-20764	Shigjetaria në Suharekë	Sport
23.	10-181-19998	Programi vjetor 2026	Sport
24.	10-181-20270	Gara dhe seminare brenda dhe jasht vendit 2026	Sport
25.	10-181-20289	Promovimi i talenteve te rinjë në boks përmes Klubit të Boksit Gravity Zone	Sport
26.	10-181-20213	Organizimi i garave në nivel komunal për SHFMU DHE SHML në Suharekë	Sport
27.	10-181-20469	Zhvillimi i kapaciteteve sportive të KV”GJINOCI 94”	Sport
28.	10-181-21038	Pjesëmarrja në gara në kuadër të FMK dhe gara ndërkombëtare	Sport
29.	10-181-19926	Java e filmit në Suharekë-Film Fest	Kulturë
30.	10-181-20980	Aktivitete kulturore OJQ-Aria	Kulturë
31.	10-181-20237	Jeta muzikore therandase –Suhareka-2026	Kulturë
32.	10-181-21020	Visionary Minds	Kulturë
33.	10-181-20958	Trashëgimia që jeton:promovim, vetëdijesim dhe anagazhim përmes aktiviteteve kulturore	Kulturë
34.	10-181-18584	Festivali i Teatrove Suharekë 7	Kulturë
35.	10-181-18579	Kësulkuqja	Kulturë
36.	10-181-18935	Ativitete Tradicionale të Shoqatës	Kulturë
37.	10-181-20796	Vallëzimet dhe Melodite e Pages	Kulturë
38.	10-181-20258	Zhvillimi i jetës kulturore në Suharekë	Kulturë
39.	10-181-20344	Lokja Festival 2026	Kulturë
40.	10-181-21804	Rinia e Suharekës një hap para tregut të punës përmes njohurive të reja në IT	Rini

41.	10-181-20462	Orientimi i hershëm i të rinjëve në karrier	Rini
42.	10-181-18296	Aktivitete rekreative sportive për gjithëpërfshirje dhe shëndet	Sport
43.	10-181-19056	Zhvillimi i aftësive të jetës për të rinjtë përmes edukimit jo formal	Rini
44.	10-181-21117	Festivali-Suhareka na bashkon	Kulturë
45.	10-181-20761	Aktivitete sportive dhe trajnime	Sport
46.	10-181-22110	Rinia në ekuilibër	Rini
47.	10-181-22116	Zhvillimi i aftësive të buta tek të rinjtë mundësi për integrim në tregun e punës	Rini
48.	10-181-22145	Nëntingujt që flasin shqip	Kulturë
49.	10-181-22057	Përshkrimi i artefakteve të Muzeut të Suharekës	Kulturë
50.	10-181-21948	Përparimi i komuniteteve në art, kulturë dhe trashëgimi	Kulturë
51.	10-181-20461	Program rinor, për edukim , trajnim, përfshirjen sociale dhe aktivizimin e të rinjëve me autizem dhe sindrom down dhe nevoja të veqanta në Komunën e Suharekës	Rini
52.	10-181-20579	Promovimi i turizmit kulturor dhe natyror të Komunës së Suharekës përmes aktiviteteve edukative dhe vizitave në terren me nxënës të shkollave të mesme dhe hartëzimi i objekteve edukativo arsimore në Komunën e Suharekës	Kulturë
53.	10-181-20947	Rëndësia e edukimit për shëndetin mendot tek shkollat fillore të mesme të ulta	Rini
54.	10-181-20766	Vetdijesim për mbrojtjen nga zjarri , parandalimi i zjarreve në fusha të hapura si dhe trajnimi i vullnetareve për zjarrfikje	Rini
55.	10-181-21061	Të rinjë të shëndetshëm , të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm	Rini
56.	10-181-21101	Laboratori i inovacionit Suharekë	Rini
57.	10-181-21114	Fuqizimi i vajzave përmes artizanatit dhe ekspozitës	Kulturë
58.	10-181-21016	Ngritja e kapaciteteve dhe shkathtësive digjitale tek të rinjtë nga Komuna e Suharekës	Rini
59.	10-181-19429	Rini e shëndetshme , mendje e fortë	Rini
60.	10-181-18972	Laboratori i së ardhmes	Rini

61.	10-181-20478	Fuqizimi i të rinjëve nga Komuna e Suharekes në Programin dhe Inteligjence Artificiale	Rini
62.	10-181-20472	Zëri që sjell ndryshime	Kulturë
63.	10-181-20919	Antologji e shkrimtarëve dhe poetëve të Komunës së Suharekës	Kulturë

Investimet Kapitale:

Ka përfunduar ndërtimi i Kullës së dëshmorve në Doberdelan .

Janë në proces ndërtimi i kullës së dëshmorit "Besim Ndreca" në Shirokë,
Ndërtimi i mini fushave të futbollit në Bllacë, Savrovë, Studenqan, Shirokë, Mushtisht dhe Gjinoc,
Ndërtimi dhe rikonstruimi i memorialeve në Leshan, Tërrnje, Sopijsë dhe Suharekë.

Suharekë
30.06.2026

Drejtore e Drejorisë:
Donjete Kabashi